

LIGJ
Nr.9684, datë 6.2.2007

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR
KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zyra e AKKP-së në qendër ka këto përgjegjësi:

a) udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji nga zyrat rajonale të qarqeve;

b) bën shqyrtimin fillestar të kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 11 të këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme, të njohur për t’u kompensuar;

c) shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve;

ç) mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Në zbatim të përgjegjësiave të veta për kompensimin, zgjidhjen e ankimeve dhe shqyrtimin kryesisht të vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 e 2 të këtij neni nuk ankimohet ose nuk shqyrtohet nga Drejtori i AKKP-së brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përmbartimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Tarifat për procedurat e kthimit dhe të kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave.”.

Neni 2

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të

pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim në zyrën e AKKP-së në qendër. Jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit.

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ka të drejtë të shqyrtojë kryesisht, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark. Drejtori i Përgjithshëm shqyrton edhe vendimet e dhëna nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Pas shqyrtimit kryesisht ose shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij;
- c) kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së.”.

Neni 3

Pas neni 28/2 shtohet neni 28/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 28/3

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, për vendimet e ish-komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të ankimuara dhe të depozituara në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para krijimit të AKKP-së, të mbetura pa shqyrtuar, shprehet me vendim brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5203, datë 8.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**